



Primitur / Dostiguar Prilipen / Prodato Received / Delivered	19.04.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Pr. / Prot. No.	Shfytim Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTOK	2225/2022		1/2



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.330/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koc-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.330/2022 të datës 05.0.2022 të parashtruar nga ankuesi Faton Morina, me adresë banimi

kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.330/2022 të datës 05.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes postës më datë 01.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill me datë 05.04.2022 dhe e regjistruar me numër A.nr.330/2022, kundër Vendimit me numër protokolli Nr.08/KA të datës 21.03.2022 të Komisionit ad-hoc për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.04.2022 me numër protokolli 1861/2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e shpallur nga Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 12.10.2021 për pozitën Zyrtar Korrektues 30 pozita në Qendrën Korrektuese në Dubravë; Vendimin me Nr. 08/KA i datës 21.03.2022 nga Komisioni ad-hoc për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ankesën datës 22.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin ad-hoc për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Listën e kandidatëve të cilët kanë kaluar intervistën me dojë për



zyrtar korrektues; Listën përfundimtare të rezultateve të testit me shkrim për pozitë zyrtar korrektues; Listën e kandidatëve të cilët kanë kaluar testin fizik të mbajtur më datë 06.02.2022; Listën përfundimtare të kandidatëve që do t'i nënshtrohen testit me shkrim për Zyrtar Korrektues; Listën e kandidatëve të cilët kanë plotësuar kriteret t'i nënshtrohen testit me shkrim për pozitën Zyrtar Korrektues; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.04.2022; Kërkesën për tërheqje të ankesës e datës 14.04.2022 me numër protokolli 2098/2022 nga ankuesi; Emailin nga e datës 14.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.330/2022 të datës 05.04.2022, **SEPSE:**

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi përmes postës më datë 01.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 05.04.2022, kundër Vendimit me numër protokolli Nr.08/KA të datës 21.03.2022 të Komisionit ad-hoc për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa i njëjti me datë 14.04.2022 përmes adresës elektronike të Këshillit ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës të datës 01.04.2022, andaj, bazuar në këtë veprim të ankuesit e në kuptim të dispozitave të nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*, Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën A.nr.330/2022 të datës 05.04.2022.

Ashtu siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.330/2022

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

